



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 63, datë 22/12/2004

**“MBI SHITBLERJEN PËR EFEKT LEGALIZIMI TË TRUALLIT
SHTETËROR TË ZËNË ME NDËRTIM TEJ LEJES SË MIRATUAR ME
VENDIMIN NR.48, DT.21/07/2001,
TË K.RR.T-SË SË BASHKISË SË TIRANËS”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 32, gërma “e”, ligjit Nr.9209, dt.23/03/2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, neni 2, pika 11, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë shitjen e sipërfaqes së truallit prej 1310 (një mijë e treqind e dhjetë) m², pasuria numër 7/187, zona kadastrale 8380 ndodhur në rrugën “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, sipas genplanit bashkëlidhur.
2. Cmimi i shitjes dhënë nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tirana 1, është 12.000 (dymbëdhjetë mijë) lekë për m².
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës dhe Drejtoria e Legalizim Shpronsimeve për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI